ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **A.K. - K.K.Gjilan**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr.**të prokurimit: 651-25-4873-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **" Rikonstruimi I rrugëve në Komunën e Gjilanit Lot 1 deri në Lot 6 "**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"Tali" Sh.p.k.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Shillovë - p.n.

(Adresa)

Gjilan

(Vendi) *(Kodi postar)* *60000*

044 500-645

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Florim Zuka

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Talishpk17@hotmail.com

(Adresa elektronike)

30/06/2025

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar GJILAN

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për Kontratë: 30.05.2025

Data e hapjes së ofertave: 30.06.2025

Korrigjimi i dosjes me: 13.06.2025

Korrigjimi i dosjes me: 18.06.2025

Kërkesë per rishqyrtim "TALI"sh.p.k 23.06.2025

Përgjigjja nga AK me 24.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐				**Jo**	☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	☐				**Jo**	☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ("**Ligji Nr.04/L-042**")

"OE: "Tali" Sh.p.k. në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik material lidhur me aktivitetin e prokurimit: **" Rikonstruimi I rrugëve në Komunën e Gjilanit Lot 1 deri në Lot 6 "** vlerëson se Autoriteti Kontraktues, ka vepruar në shkelje të parimeve bazike dhe parimeve kryesore, duke shkelur dispozitat qenësore të LPP-së si në vijim:

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 10 LPP-së
Neni 11 LPP-së
Neni 56 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 46 i RRPP 2022

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimet ankimore 1

"**Kërkesë për rishqyrtim për pikat:**

9.1& 9.2 f) 3 Teknikë të dip. të ndërtimtarisë (me së paku 5 vite përvojë pune profesionale) dhe Aneksi 8. LISTA E PAJISJEVE DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM

Në dokumentacionin e tenderit kërkohet që operatori ekonomik të ketë në dispozicion 3 teknikë të diplomuar, si kriter kualifikimi teknik. Duke vlerësuar me seriozitet këtë kërkesë, dëshirojmë të

theksojmë se projekti është i ndarë në 6 lote të ndryshme, dhe çdo operator ekonomik ka të drejtë të fitojë vetëm një lot. Në këtë kuadër, konsiderojmë se kërkesa për 3 teknikë të diplomuar për çdo pjesëmarrës është jo proporcionale dhe jo e arsyeshme në raport me vëllimin e punës që do të kërkohet në rast të fitimit të vetëm një loti. Për këtë arsye, kërkojmë rishqyrtimin dhe përshtatjen e këtij kriteri, duke propozuar që numri i teknikëve të kërkuar të jetë proporcional me numrin e loteve që operatori ekonomik synon të fitojë, ose të lejohet fleksibilitet për raste kur operatori konkurron vetëm për dy lote dhe mund të jetë fitues i vetëm një loti.Ky ndryshim do të krijonte një mjedis më konkurrues dhe më të drejtë për të gjithë operatorët ekonomikë, pa kompromentuar cilësinë apo integritetin e zbatimit të kontratës.

2. **4.Cilinder gomë hekur 2- 2.5 ton**

Nga këndvështrimi ynë profesional dhe praktik, për punët që parashihen në këtë projekt, përdorimi i një cilindri kompaktues nuk varet domosdoshmërisht nga një gamë specifike e peshës së tij, pasi edhe modele të tjera përmbushin efektshmërinë teknike të kërkuar. Për më tepër, specifikimi kaq i ngushtë i peshës së cilindrit (2 – 2.5 ton) nuk justifikohet si domosdoshmëri teknike, përveç nëse është i shoqëruar me analizë të veçantë ose studim të fizibilitetit që e argumenton këtë nevojë.

Në këtë kontekst, kërkojmë nga autoriteti kontraktues:

1. Sqarim teknik mbi arsyetimin dhe domosdoshmërinë e përcaktimit të saktë të peshës së cilindrit në këtë interval specifik;
2. Rishqyrtim të këtij kriteri, duke propozuar që të lejohet përdorimi i pajisjeve ekuivalente që ofrojnë rezultate teknike të njëjta ose të krahasueshme.

Qëllimi ynë është të garantojmë një proces të hapur, konkurrues dhe të drejtë për të gjithë operatorët ekonomikë, si dhe të shmangen specifikimet që mund të jenë kufizuese pa një arsye të qartë teknike. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga autoriteti kontraktues që të ndryshoj kriteret.

VENDIM

I.REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e: OE " **Tali** " **Sh.p.k Gjilan**, e parashtruar me dt. **09.06.2025** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Rikonstruimi I rrugëve në Komunën e Gjilanit Lot 1 deri në Lot 6** " **me** Nr. të Prok: **651-25-4873-5-1-1 dhe me nr. të brendshëm 651-25-4873-5-1-1** kundër Njoftimit për Kontratë - B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve **ne** njoftimet e publikuara - Version i korigjuar ***të dt. 18.06.2025*** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

II.VËRTETOHET - Njoftimi për Kontratë - B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara - Version i korigjuar ***të dt. 18.06.2025***, - **Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjilanit** vendos të vazhdojë më tutje me procedurën e prokurimit të përcaktuar si në pikën një dhe dy të këtij vendimi.

IV.NJOFTOHET OE " **Tali** " **Sh.p.k Gjilan**,si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur **me këtë** vendim përmes publikimit në platformën elektronike në adresë"https://e-prokurimi.rks-gov.net.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe publikimit në platformën e-prokurimi.

AK ka hedhur poshte te gjithe ankesen duke u bazuar ne nenin 108A dhe si pasojë ka rezultuar ne:

Shkelje te parimit të proporcionalitetit – Neni 7.2 i LPP
Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 7 pika 2, se:
"Autoritetet kontraktuese do të sigurojnë që kërkesat për pjesëmarrje të jenë të përshtatshme dhe proporcionale me natyrën dhe vlerën e kontratës."

Kërkesa për 3 teknikë të diplomuar mund të jetë e justifikuar për të gjithë tenderin apo për një projekt të madh, **por jo për një lot të vetëm**, që përfaqëson vetëm një pjesë të aktivitetit të përgjithshëm.

Shkelje e konkurrencës së lirë – Neni 7.1 dhe 7.3 i LPP
Kjo kërkesë **kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë**, përfshirë ata që në mënyrë të ligjshme dhe me përvojë të mëparshme do të mund të ofronin shërbimin në mënyrë profesionale, por që nuk kanë 3 teknikë të diplomuar në dispozicion për vetëm një lot.

Sipas nenit 7.3, autoritetet kontraktuese janë të detyruara të garantojnë një procedurë të ndershme dhe konkuruese, gjë që në këtë rast është **e cenuar.**

Neni 28, paragrafi 4 i Ligjit për Prokurimin Publik kërkon që specifikimet teknike të jenë të qarta, jo-diskriminuese dhe të bazuara në performancë funksionale.

Mungesa e specifikimeve të detajuara për Cilindrin natyrisht që mundëson favorizim të mundshëm të ndonjë OE të caktuar, duke cenuar konkurrencën e ndershme.
Kjo situatë bie ndesh me parimin e barazisë dhe transparencës, të garantuar me nenin 7 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Mungesa e specifikimeve të qarta cenon konkurrencën dhe mundëson favorizim të paarsyeshëm.

Vlen te ceket se kerkesa per rishqyrtim e parashtruar eshte me date 23.06.25 dhe jo siç ceket tek vendimi I AK-se se eshte me 09.06.2025. E gjithe kjo tregon seriozitetin e AK lidhur me kerkesen tone per rishqyrtim!

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kompensim i dëmeve materiale për shpenzimet procedurale, kompensim i fitimit të humbur nga kjo punë që do të kërkohet në vazhdim.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*